



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 17, datë 06.03.2024

PËR MIRATIMIN PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, DREJTORISË RAJONALE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE DURRËS, TË AMBJENTIT ME SIPËRFAQE NDËRTIMI 199 M², DHE SIPËRFAQE FUNKSIONALE 21.4 M², E NDODHUR NË KATIN E PARË TË GODINËS SË SHKOLLËS SË MESME TË BASHKUAR ME ORIENTIM ARTISTIK “JAN KUKUZELI”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja b dhe nënpika 1.2, shkronja c, nenit 54, shkronja e/1, nenit 55, pikat 3 dhe 6 të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.536, datë 01.05.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar, Ligjit nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 901 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, shkresës nr. 47 prot., datë 08.01.2024, ardhur nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, administruar nga Bashkia me nr.402 prot., datë 10.01.2024, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore dhe Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Sporteve, Komuniteteve Fetare, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin për dhënie në përdorim, pa kundërshtëpërblim, Drejtorisë Rajonale Arsimore Parauniversitare Durrës, të ambjentit me sipërfaqe ndërtimi 199 m², dhe sipërfaqe funksionale 21.4 m², e ndodhur në katin e parë të Godinës së Shkollës së Mesme të Bashkuar me Orientim Artistik “Jan Kukuzeli”, pronë e Bashkisë Durrës, për një afat kohor 5 (pesë) vjet, për t’u përdorur për administratën e kësaj Drejtorie, sipas planimetrisë dhe kontratës së huapërdorjes,

e lidhur midis Bashkisë Durrës, në cilësinë e “Huadhënësit” dhe Drejtorisë Rajonale Arsimore Parauniversitare Durrës, në cilësinë e “Huamarrësit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Drejtoria Ligjore dhe Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 07.03.2024





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI I PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETETEVE

Nr. _____ prot.

Durrës, më ____ . ____ .2024

DRAFT KONTRATË HUAPËRDORJE

NR.....DT.....2024

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, DREJTORISË RAJONALE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE DURRËS, TË AMBJENTIT ME SIPËRFAQE NDËRTIMI 199 M², DHE SIPËRFAQE FUNKSIONALE 21.4 M², E NDODHUR NË KATIN E PARË TË GODINËS SË SHKOLLËS SË MESME TË BASHKUAR ME ORIENTIM ARTISTIK “JAN KUKUZELI”

Sot më dt. ____ .2024, në ambjentet e Bashkisë Durrës, sipas Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 27.2.2019, “ Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të arsimit parauniversitar”, VKM-së nr.536, datë 01.05.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. __, datë ____ .2024, “Për miratimin për dhënie në përdorim pa kundërshtpërblim, Drejtorisë Rajonale Arsimore Parauniversitare Durrës, të ambjentit me sipërfaqe ndërtimi 199.4 m², ku sipërfaqe funksionale 21.4 m², e ndodhur në katin e parë të godinës së Shkollës së Mesme të Bashkuar me Orientim Artistik “Jan Kukuzeli”, kërkesës së Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, që mban nr. 47 prot., datë 08.01.2024, ardhur nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, administruar nga bashkia me nr. 402 prot., datë 10.01.2024, me lëndë: “Kërkesë për dhënie në përdorim ambjenti”, nenit 901 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Bashkia Durrës, së bashku me huamarrësin bien dakort të hartojnë këtë kontratë huapërdorje me kushtet si më poshtë:

Huadhënës: Bashkia Durrës, përfaqësuar nga kryetar zj. Emiriana Sako.

Huamarrës: Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare Durrës, përfaqësuar nga
Drejtori z.Hazbi Lika

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

OBJEKTI

- 1.1 Objekti i kësaj kontrate huapërdorje është dhënia në gëzim të përkohshëm të ambientit me sipërfaqe ndërtimi 199.4 m², dhe sipërfaqe funksionale 21.4 m², e ndodhur në katin e parë të godinës së Shkollës së Mesme të Bashkuar me Orientim Artistik "Jan Kukuzeli", pronë e Bashkisë Durrës, sipas planimetrisë bashkëlidhur.

NENI 2

QËLLIMI I PËRDORIMIT

- 2.1 Qëllimi i përdorimit të ambientit objekt i kontratës së huapërdorjes është për t'u përdorur për administratën e Drejtorisë Rajonale Arsimore Parauniversitare Durrës.
- 2.2 Ky ambient nuk mund të përdoret për qëllime të tjera, përveç destinacionit të përcaktuar në nenin 2, pika 2.1.

NENI 3

KOHËZGJATJA

- 3.1 Kjo kontratë është e vlefshme për 5 (pesë) vjet dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.
- 3.2 Kontrata nuk ripërtërihet pas kalimit të afatit pesë vjeçar pa miratimin e Këshillit Bashkiak.

NENI 4

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E HUADHËNËSIT

- 4.1 "Huadhënësi" lejon përdorimin e pronës, e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t'u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet dokumenti i emërtuar "Proces Verbal", ku do të pasqyrohet gjendja fizike e ambientit, objekt kontrate, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.
- 4.2 "Huadhënësi" ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e "Huamarrësit".
- 4.3 "Huadhënësi" është i detyruar të garantojë "Huamarrësin" për gëzimin e qetë të sendit objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.
- 4.5 "Huadhënësi" ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur "Huamarrësi" shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 15 ditë përpara me shkrim.
- 4.6 "Huadhënësi" nuk është i detyruar të garantojë "Huamarrësin" nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.
- 4.7 Në rast të ndryshimit të adresës nga njëra palë, kjo e fundit detyrohet t'i komunikojë palës tjetër adresën e re. Në rast të kundërt komunikimet e dërguara në adresën e mëparshme konsiderohen të vlefshme.
- 4.8 Në çdo rast, Bashkia (Huadhënësi) ka të drejtë që të bëjë njoftime me shpallje publike në stendën e Bashkisë dhe në ambientin objekt kontrate (Shkolla). Shpallja qëndron 5 ditë afishuar dhe pas plotësimit të afatit 5 ditor, njoftimi konsiderohet i marrë rregullisht dhe i njohur për palën tjetër.
- 4.9 "Huadhënësi" dorëzon me procesverbal ambientin e dhënë pa shpërblim në kohën e caktuar në

këtë kontratë.

NENI 5

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E HUAMARRËSIT

- 5.1 "Huamarrësi" ka të drejtë që sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me huapërdorje dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.
- 5.2 "Huamarrësi" ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar.
- 5.3 "Huamarrësi" detyrohet që në pasurinë e marrë me huapërdorje, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2 të kësaj kontrate.
- 5.4 "Huamarrësi" detyrohet të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë objektin e kontratës së huapërdorjes.
- 5.5 "Huamarrësi" detyrohet të përballojë me shpenzimet e tij, detyrimet që lidhen me dëmet e shkaktuara eventualisht palëve të treta.
- 5.6 "Huamarrësi" detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate, të dorëzojë pronën të padëmtuar.
- 5.7 "Huamarrësi", në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa e dëmtuar atë. "Huadhënësi" nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga "Huamarrësi".
- 5.8 "Huamarrësi" nuk lejohet, që pronën e dhënë me huapërdorje t'a japë me nënpërdorje ose t'ja kalojë kontratën një tjetri.
- 5.9 "Huamarrësi" në asnjë rast nuk mund t'a rëndojë me barrë pronën objekt kontrate.
- 5.10 Në ngarkim të "Huamarrësit" janë të gjitha detyrimet ndaj të tretëve si Ujësjellës Kanalizime, Furnizimit me Energji Elektrike. Për furnizimin me energji elektrike dhe Ujësjellës-kanalizime. Huamarrësi do të lidhë kontratë furnizimi me entet furnizues.
- 5.11 "Huamarrësi" nuk mund të kërkojë pagimin e shpenzimeve që ka bërë për të përdorur sendin.
- 5.12 "Huamarrësi" është i detyruar të bëjë me shpenzimet e tij ndreqjet e zakonshme të sendit të dhënë me huapërdorje.
- 5.13 "Huamarrësi" me mbarimin e afatit duhet t'a kthejë ambjentin e marrë në gjendje të përkohshme në gjendjen sipas përshkrimit të procesverbalit të dorëzimit.



NENI 6

ZGJIDHJA DHE MBARIMI I HUAPËRDORJES

Huapërdorja mund të zgjidhet me kërkesën e Huadhënësit edhe para mbarimit të afatit në këto raste:

- 6.1 Kur huamarrësi nuk e përdor ambjentin sipas destinacionit dhe qëllimit të kontratës.
- 6.2 Kur huamarrësi e keqpërdor, e dëmton dhe nuk kujdeset për ruajtjen e sendit.
- 6.3 Kur huamarrësi ja kalon sendin një personi të tretë, pa pëlqimin e huadhënësit.
- 6.4 Në rast se huamarrësi nuk e dorëzon vullnetarisht objektin e kontratës brenda afatit të caktuar, Huadhënësit i lind e drejta e lirit të ambjenteve.

NENI 7

PËRGJEGJËSITË E PALËVE

- 7.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

- 7.2 Me "Forcë madhore" do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si: tërmetet, përmbytjet, lufta. Në këto raste palët janë të detyruara të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim.
- ~ Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

NENI 8 DISPOZITAT E FUNDIT

- 8.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t'u referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.
- 8.2 Pjesë e kësaj kontrate është proces-verbali i marrjes në dorëzim të objektit; planimetria e ambjenteve objekt kontrate.
- 8.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Shkallës së Parë, Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
- 8.4 Në çdo rast të mosmarrëveshjeve, autorizohet Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve , si njësia monitoruese të kontratës së huapërdorjes, për ndjekjen e procedurës gjyqësore.

NENI 9

Kjo kontratë është formuluar në gjashtë kopje origjinale. Tre kopje i mban "Huamarrësi", një kopje Shkolla Mesme e Bashkuar me Orientim Artistik "Jan Kukuzeli" dhe dy kopje Huadhënësi.

HUAMARRËSI
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR DURRËS
DREJTOR

Hazbi Lika

HUADHËNËSI
BASHKIA DURRËS

KRYETAR

Emiriana Sako





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 162 / Prot.
3

Durrës, më 18.03 .2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.17 datë 06.03.2024 “Për miratimin për dhënie në përdorim, pa kundërshtim, Drejtorisë Rajonale Arsimore parauniversitare Durrës, të ambientit me sipërfaqe ndërtimi 199 m², dhe sipërfaqe funksionale 21.4 m², e ndodhur në katin e parë të godinës së shkollës së mesme të bashkuar me orientim artistik “Jan Kukuzeli”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

